



# Udhëzime për ruajtjen e privatësisë në media



[www.coe.int/freedomofexpression](http://www.coe.int/freedomofexpression)  
[www.coe.int/dataprotection](http://www.coe.int/dataprotection)

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

# Udhëzime për ruajtjen e privatësisë në media

Edicioni në gjuhën angleze:

*Të gjitha të drejtat e rezervuara. I licencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara*

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian.

Të gjitha kërkesat në lidhje me riprodhimin ose përkthimin e të gjithë ose një pjese të këtij dokumenti duhen t'i drejtohen Drejtorisë për Komunikim (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë dokument duhet t'i drejtohet Komitetit për Media dhe Shoqëri të Informacionit (CDMSI) dhe Komiteti i Konventës 108 (Këshilli i Evropës Konventa për Mbrojtjen e të Dhënave).

Foto: Këshilli i Evropës  
Kopertina dhe faqosja: Dokumentet dhe Departamenti i Prodhimit të Publikimeve (SPDP), Këshilli i Evropës

Botimi është përkthyer në gjuhën shqipe në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022 " dhe projekti Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave në Kosovë\* (JUFREX) ".

*\*Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.*

# Tabela e përmbajtjes

<b>1. HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>2. LIRIA E SHPREHJES, ROLI I MEDIAS DHE GAZETARIA E PËRGJEGJSHME</b>	<b>7</b>
2.1. Liria e shprehjes	7
2.2. Media si rojtarë publikë me të drejta dhe përgjegjësi	7
2.3. Gazetaria e përgjegjshme k. gazetarisë tabloid	8
<b>3. JETA PRIVATE DHE KUSHTET PËR PUBLIKIM TË ÇËSHTJEVE PRIVATE</b>	<b>10</b>
3.1. Jeta private	10
3.2. Pëlqimi	10
3.3. Interesi publik	11
3.4. Korniza për balancimin e të drejtave për privatësi dhe liri të shprehjes	14
<b>4. ÇËSHTJET SPECIFIKE TË JETËS PRIVATE</b>	<b>18</b>
4.1. Familja, shtëpia, prona	18
4.2. Integriteti fizik dhe moral	19
4.3. E drejta ndaj imazhit të tjetrit	20
4.4. Korrespondenca	22
<b>5. RAPORTIMI I KRIMEVE</b>	<b>23</b>
5.1. Parimet e përgjithshme	23
5.2. Të drejtat e viktimave (të mitur) për mbrojtjen e identitetit të tyre	23
5.3. E drejta për privatësi të një pedofili të prezumuar	23
5.4. Zbulimi i identitetit të zyrtarit policor të hetuar	24
5.5. Personat e dyshuar	24
5.6. Publikimi i aspekteve banale të personave të akuzuar	24
5.7. Personat nën përkujdesje	24
5.8. Personat e dënuar në situata emocionale	25
5.9. Personat e dënuar të liruar me kusht	25
<b>6. KODET E SJELLJES DHE MJETET VETËRREGULLUESE</b>	<b>26</b>
<b>7. PARIMET E MBROJTJES SË TË DHËNAVE</b>	<b>27</b>
7.1. Të drejtat e individëve	27
7.2. Masat e sigurisë	29
7.3. Përpunimi i përmbajtjes joeditoriale	29
7.4. Praktikat më të mira për të siguruar dhe demonstruar pajtueshmëri	30
<b>8. REFERENCAT</b>	<b>31</b>
Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore	27
Neni 8 – E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare	29
Neni 10 - Liria e shprehjes	29
Dokumente të Këshillit të Evropës	30
Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut	30



# 1. HYRJE

---

**U**dhëzimet e tanishme përmbajnë një përmbledhje të standardeve të Këshillit të Evropës (Këshilli/KiE-ja) dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Gjykata) në lidhje me mbrojtjen e privatësisë së figurave publike dhe individëve privatë në media<sup>1</sup>. Ato gjithashtu përfshijnë parimet e mbrojtjes së të dhënave, duke u bazuar në instrumente të ndryshme rregulluese dhe praktikat më të mira.

Sa u përket standardeve për balancimin dhe përforcimin e ndërsjellë të të drejtave për jetën private dhe lirinë e shprehjes, ato janë të strukturuar në pesë seksione dhe së pari ofrojnë një përmbledhje të së drejtës për lirinë e shprehjes, rolin e mediave dhe nocionin e gazetarisë së përgjegjshme. Ato pastaj e elaborojnë konceptin e jetës private dhe kushtet për publikimin e çështjeve private, duke dhënë shembuj specifikë të rasteve që përfshijnë raportim mbi aspektet private të jetës. Së fundmi, standardet përmbajnë standarde kryesore për ruajtjen e privatësisë gjatë raportimit të krimit. Ekziston edhe një pjesë shtesë në lidhje me rëndësinë e kodeve të etikës gazetare dhe mjeteve të tjera vetërregulluese.

Udhëzimet u drejtohen gazetarëve<sup>2</sup> dhe profesionistëve të tjerë të mediave dhe synojnë t'i ndihmojnë ata për zbatimin praktik të standardeve të përmendura, kur kanë dilema individuale të lidhura me etikën. Për këtë arsye, janë hequr detajet e testeve ligjore dhe ushtrimet e të drejtave balancuese.

Referencat për raste gjyqësore përfshihen në pjesën e fundit të udhëzimeve për ata që janë të interesuar ta ekzaminojnë praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe standardet e ligjit të butë të Këshillit nga një perspektivë ligjore.

1. Për qëllime të këtyre udhëzimeve, termi "media" duhet të kuptohet në përputhje me standardet e zbatueshme të Këshillit të Evropës të përcaktuara në seksionin Referencat dhe veçanërisht me Rekomandimin CM/Rec(2018)1 për pluralizmin e mediave dhe transparencën e pronësisë së mediave dhe Rekomandimin CM/Rec(2011)7 për një nocion të ri të mediave.
2. Për qëllime të këtyre udhëzimeve, termi "gazetar" duhet të kuptohet në përputhje me standardet e zbatueshme të Këshillit të Evropës të përcaktuara në seksionin Referencat dhe veçanërisht me Rekomandimin CM/Rec(2016)4 për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe të aktorëve të tjerë të mediave.

Udhëzimet përqendrohen vetëm te standardet ekzistuese të Këshillit dhe Gjykatës (përveç në pjesën që i adreson parimet e mbrojtjes së të dhënave, të cilat gjithashtu përfshijnë standardet kombëtare dhe të BE-së dhe praktikat më të mira); ato as nuk prezantojnë standarde të reja dhe as nuk kanë ndonjë fuqi juridike. Ato duhet të konsiderohen si një mjet këshillëdhënës. Duke pasur parasysh që ato synojnë të jenë koncize, të shkurtra dhe që aplikohen lehtë, udhëzimet përqendrohen vetëm në pikat më të rëndësishme të mbrojtjes së privatësisë në media. Gazetarët që i përdorin ato inkurajohen të japin informata kthyesë dhe udhëzimet janë të hapura për azhurnime të mëtejshme dhe përmirësime në të ardhmen.

## 2. Liria e shprehjes, roli i medias dhe gazetaria e përgjegjshme

### 2.1. Liria e shprehjes

E drejta e lirisë së shprehjes është e drejtë e garantuar për të gjithë. Ajo përfshin të drejtën e lirisë së mendimit dhe të marrjes dhe shpërndarjes së informatave dhe ideve pa ndërhyrje nga autoritetet publike. Sidoqoftë, shtetet kanë të drejtë të kërkojnë licencim për ndërmarrjet e transmetimit, televizionet dhe kinematë.

Kjo e drejtë është një element thelbësor i një shoqërie demokratike dhe një kusht themelor për përparimin e saj dhe për vetëpërmbushjen e secilit individ. Duke shkuar përtej informacionit dhe ideve që merren ose vlerësohen në mënyrë të favorshme si joofenduese ose si çështje të indiferencës, e drejta për lirinë e shprehjes përfshin edhe informacione që mund të ofendojnë, shokojnë apo edhe shqetësojnë.

Pluralizmi i mediave është një aspekt i rëndësishëm i së drejtës së lirisë së shprehjes. Në një shoqëri demokratike, pluralizmi i mendimeve në media jo vetëm që duhet të tolerohet, por edhe të promovohet dhe lehtësohet në mënyrë aktive. Zërat dhe opinionet e ndryshme të pranishme në një shoqëri, duhet të përfshihen dhe reflektohen në media. Në këtë mënyrë ndërtohet toleranca dhe mendjegjerësia.

### 2.2. Media si rojtarë publikë me të drejta dhe përgjegjësi

Anëtarët e mediave konsiderohen të jenë rojtarë publikë me rol jetësor në një shoqëri demokratike. Ata e kanë për detyrë të japin informata dhe ta informojnë publikun për të gjitha çështjet me interes publik, të cilat edhe publiku ka të drejtë t'i dijë.

Sidoqoftë, e drejta e një gazetari për lirinë e shprehjes nuk është absolute. Gazetarët kanë të drejta dhe përgjegjësi. Në këtë drejtim, termi “të drejta” interpretohet si prerogativë e gazetarit për të ushtruar profesionin e tij dhe për të raportuar për çështje me interes publik, ndërsa termi “përgjegjësi” do të thotë që ata duhet të veprojnë me mirëbesim dhe të japin informacion të saktë dhe të besueshëm në përputhje me etikën e gazetarisë.

Gazetarëve u kërkohet t'i verifikojnë faktet përpara se t'i publikojnë ato, megjithëse e njëjta kërkesë nuk zbatohet kur raportojnë dhe shpërndajnë gjykime (opinione) të vlerave. Sidoqoftë, edhe opinionet duhet të kenë bazë të faktuar. Në rastin Bodrožićk. Serbisë, Gjykata e konstatoi të pranueshme që një gazetar të kritikonte një



historian duke e quajtur “idiot” dhe “fashist”, sepse mendimi i tij ishte botuar si përgjigje ndaj një paraqitjeje nga historiani në një shfaqje televizive, ku ai kishte diskutuar për tensionet etnike dhe nacionale në Ballkan. Fjalët fyese nuk duheshin interpretuar si deklarime të fakteve, por si një opinion reagues ndaj intolerancës së vetë historianit ndaj pakicave kombëtare.

Në rrethana të veçanta, është e justifikuar që gazetarët të mos verifikojnë deklaratimet e faktuara. Për shembull, kur gazetarët raportojnë për përmbajtjen e raporteve zyrtare ose informacioneve nga qeveria ose të dhënave publike, atyre nuk u kërkohet të kryejnë hulumtime shtesë të pavarura për t’i verifikuar ato fakte.

Varet nga gazetarët që të vendosin se si paraqitet një artikull për shtyp dhe atyre u lejohet ta përdorin një shkallë të caktuar ekzagjerimi ose edhe provokimi. Prandaj, ata mund të zgjerojnë artikuj dhe të përpiqen t’i paraqesin në mënyrë tërheqëse, me kusht që artikujt të mos keqpërfaqësojnë ose t’i çorientojnë lexuesit.

Në raportimin e çështjeve të privatësisë, gazetarët mund të kufizohen me urdhër gjykateje, sepse kufizimi paraprak mbi publikimet është i ndaluar. Sidoqoftë, është e rëndësishme të dihet se autoriteteve gjyqësore u kërkohet t’i vlerësojnë me kujdes urdhrat në lidhje me shtypin, sepse lajmi është një mall me afat të shkurtër, nëse vonohet publikimi i tij, qoftë edhe për një periudhë të caktuar, mund të humbë e gjithë vlera e tij dhe interesi i publikut për të.

Kurdo që të jetë e mundur dhe praktike, gazetarët duhet të kërkojnë komente nga subjektet e raporteve të tyre, megjithëse nuk janë të detyruar t’i informojnë ata parapublikimit ose transmetimit. Në rastin Mosley k. Mbretërisë së Bashkuar, personi në fjalë u fotografua dhe u filmua duke marrë pjesë në aktivitete sado-masokiste me prostituta. Ai e paditi me sukses një gazetë për shkelje të së drejtës së tij për privatësi, por gjithashtu u përpoq që me forcë ta detyrojë median që t’i njoftojë personat në fjalë para se ta publikojë materialin për ta. Sidoqoftë, Gjykata vendosi se nuk ishte e nevojshme që media t’i njoftonte paraprakisht për publikimet e synuara ata që paraqiteshin në to.

### **2.3. Gazetaria e përgjegjshme k. gazetarisë tabloid**

Gazetaria e përgjegjshme do të thotë që gazetarët ta ushtrojnë profesionin e tyre duke vepruar me mirëbesim dhe duke mbledhur dhe shpërndarë informacione në përputhje me etikën e gazetarisë. Ata duhet të sigurohen që raportimi të jetë i ekuilibruar dhe të përpiqen në mënyrë të përsëritur t’i kontaktojnë personat në fjalë për një koment para publikimit.

Gazetaria tabloid nënkupton që informacionet personale (veçanërisht fotot) mbledhen në një klimë ngacmimi të vazhdueshëm, e cila mund të nxisë një ndjenjë shumë të fortë të ndërhyrjes në jetën private ose edhe të ndjekjes penale të personave të përfshirë.

Një element i rëndësishëm i vlerësimit ligjor lidhet me atë nëse informacionet personale të personave të njohur publikohen nga një gazetar duke iu përmbajtur parimeve të gazetarisë së përgjegjshme ose nga tabloidët që publikojnë informacione të tilla vetëm për ta kënaqur kureshtjen e publikut. Gazetarët që ushtrojnë gazetari të përgjegjshme gëzojnë mbrojtje më të fortë të së drejtës së tyre për lirinë e shprehjes. Sidoqoftë, nuk u takon autoriteteve kombëtare që të vendosin se cilat teknika të raportimit duhet të përdoren nga gazetarët.

Gazetarët duhet të jenë të ndërgjegjshëm që publiku nuk ka nevojë të dijë vendndodhjet e një personi të njohur, sjelljet e tij në jetën private ose paraqitjet e këtij personi në vende që joggjithmonë mund të përshkruhen si tërësisht private.

Publikimet e fotografive me komente shoqëruese që lidhen ekskluzivisht me detaje të jetës private, kur merren pa pëlqim dhe veçanërisht fshehtas e nga distanca, ka të ngjarë të cenojnë të drejtën për privatësi të figurave publike. Foto të tilla nuk konsiderohen domosdoshmërisht kontribuuese në një debat me interes të përgjithshëm. Ky standard është edhe më i rreptë në rastet e individëve privatë.

Gazetarët në parim janë të detyruar t'i respektojnë ligjin dhe kodet etike gjatë raportimit të lajmeve dhe duhet të kenë kujdes më të madh në situatat që mund të rezultojnë me shkelje të ligjeve në fuqi. Thyerja e ligjit mund të justifikohet vetëm në situatat kur interesi për informimin e publikut tejkalon detyrën për t'iu bindur ligjit të zakonshëm (penal). Për shembull, një gazetar duhet të zbatojë një urdhër të policisë për ta braktisur vendin e ngjarjes gjatë demonstratave publike ose rreziqeve për ndalim nga zyrtarët e zbatimit të ligjit. Në të njëjtën mënyrë, gazetarët që zgjedhin, për shembull, të blejnë në mënyrë të paligjshme armë zjarri për të provuar se armët mund të jenë lehtësisht të arritshme, nuk mund të presin që të përjashtohen nga ndjekja penale.

# 3. Jeta private dhe kushtet për publikim të çështjeve private

---

## 3.1. Jeta private

E drejta për jetë private i garantohet secilit.

Nocioni i jetës private është një term i gjerë, pa përkufizim strikt, që përfshin integritetin fizik dhe psikologjik të një personi dhe aspektet e shumta të identitetit të një personi si: identifikimin gjinor dhe orientimin seksual, emrin ose elementët që lidhen me të drejtën e një personi për imazhin e tij, por nuk kufizohet vetëm në këto çështje. Reputacioni i një personi është gjithashtu pjesë e së drejtës për jetën private.

Jeta private përfshin të drejtën për të krijuar dhe zhvilluar lirshëm marrëdhënie (përfshirë ato romantike) me qeniet e tjera njerëzore. Për më tepër, informacionet që lidhen me gjendjet mjekësore, adresat e shtëpive, atësitë e fëmijëve jashtëmartesorë dhe aktivitetet seksuale, konsiderohen se janë brenda sferës së jetës private.

E drejta për privatësi do të thotë që të gjithë, d.m.th. figurat private dhe publike, kanë të drejtë të jetojnë privatisht larg vëmendjes së padëshiruar (subjekt i disa përjashtimeve).

Si parim, publikimi që ka të bëjë me çështje strikte private cenon të drejtën e respektimit të jetës private, përveç nëse merret pëlqimi i personit në fjalë ose publikimi i tillë konsiderohet në interes të publikut. Si të tilla, vendimet për atë që konsiderohet si çështje private dhe për atë që ka hyrë në një sferë publike, duhet të merren nga vetë gazetarët sipas rastit.

Sa më intim të jetë aspekti i jetës private që shpaloset, aq më serioz duhet të jetë arsyetimi.

## 3.2. Pëlqimi

Si rregull i përgjithshëm, informacioni për çështje personale nuk duhet të bëhet publik pa pëlqimin e personit në fjalë. Pëlqimi është një element i rëndësishëm gjatë përcaktimit nëse publikimi i një detaji nga jeta private ndërhyr në të drejtën për privatësi.

Megjithatë, informacioni mbi individët gjithashtu mund të publikohet pa pëlqim nëse ekziston një interesim mbizotërues i publikut, d.m.th. nëse zbulimi i informacionit justifikohet nga një interes ose shqetësim i përgjithshëm, i cili konsiderohet t'i mbizotërojë konsideratat e privatësisë së individit në fjalë. Koncepti i interesit publik mund të përbëjë pra një "arsyetim alternativ" për publikim.

Duke pretenduar shkelje të së drejtës së saj për privatësi, princesha Caroline von Hannover u ankua disa herë për publikimin e fotografive nga sfera e saj private në revista gjermane. Gjykata shqyrtoi gjithashtu mënyrën e marrjes së fotografive, duke theksuar rëndësinë e marrjes së pëlqimit të personave të përfshirë.

Për shembull, në rastin Von Hannover 2 k. Gjermanisë, një fotografi e princeshës në një festë skijimi u publikua së bashku me një artikull për sëmundjen e babait të saj, i cili u konstatua se kontribuon në një debat me interes të përgjithshëm. Prandaj, edhe në mungesë të pëlqimit të saj, publikimi u konstatua se ishte i justifikuar.

Sidoqoftë, në çdo publikim pa pëlqim, rregulli është: sa më private të jetë çështja, aq më e madhe është thirrja për kujdes. Për shembull, marrëdhëniet romantike të një personi janë në parim një çështje rreptësisht private. Prandaj, detajet në lidhje me jetën seksuale të një individi ose marrëdhëniet intime, lejohen të bëhen publike pa pëlqim, në rrethana përjashtuese. Ky ishte rasti në Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës, të shtjelluar më poshtë.

Në praktikë, informacioni dhe imazhet e publikuara me pëlqimin e personave të përfshirë, në përgjithësi nuk paraqesin probleme. Procedurat gjyqësore kryesisht inician në rastet kur nuk është marrë pëlqimi i tillë. Në kapitujt në vijim do të paraqiten disa raste të Gjykatës në të cilët materiali u publikua pa pëlqimin e personit. Autorët, megjithatë, argumentuan se publikimet përkatëse ishin në interes të publikut.

### **3.3. Interesi publik**

Në përgjithësi, interesi publik ka të bëjë me çështje që e prekin ose shqetësojnë ndjeshëm publikun deri në atë masë, sa që me të drejtë (legjitime) tërheqin vëmendjen e tij.

Fushat që konsiderohen të jenë me interes publik përfshijnë: keqpërdorim të detyrës publike, shfrytëzim jo të duhur të parasë publike, mbrojtje të shëndetit publik, siguri dhe mjedis, mbrojtje të sigurisë kombëtare, krim dhe sjellje sociale dhe tema të ngjashme politike dhe socio-ekonomike, ndonëse nuk janë të kufizuara vetëm në këto çështje.

Gazetarët mund të publikojnë informacione të rëndomta personale të të tjerëve kur ishërbejnë një vlerë më të madhe dhe përdoren për ta diskutuar një çështje në interes të publikut (informacioni personal i publikuar duhet të shërbejë për ndonjë qëllim të rëndësishëm). Sa më e madhe të jetë vlera e informacionit për publikun, aq më i madh duhet të jetë interesi i personit për t'u mbrojtur kundër publikimit dhe anasjelltas.

Njëjtë, gazetarët mund ta ripublikojnë informacionin personal të bërë tashmë publik nga personi në fjalë. Në rastin Krone Verlag GmbH & Co. KG k. Austrisë, një gazetar mori dhe përdori një fotografi të një politikani nga uebfaqja e Parlamentit për ta shoqëruar një artikull që zbulonte se ai gjoja kishte marrë paga të paligjshme. Gazetarët gjithashtu mund t'i ripublikojnë informacionin dhe fotografitë e individëve privatë që u publikuan fillimisht me pëlqimin e tyre, për aq sa informacioni është çështje me interes të ligjshëm publik (Eerikainen dhe të tjerët k. Finlandës).

Është e vështirë të përcaktohet qartë interesi publik për shkak të rrezikut të përjashtimit të disa çështjeve ose të propozimit të një përkufizimi tepër të ngushtë. Vendimi për të publikuar informacion personal të një figureje publike ose personi privat do të varet gjithmonë nga rrethanat e rastit. Kështu që gazetarët pritet ta aplikojnë testin e interesit publik dhe ta balancojnë fuqinë e konsideratave në favor dhe kundër zbulimit, sipas rastit.

Gjatë përcaktimit të interesit publik, ajo që duhet të ketë rëndësi për gazetarët është nëse lajmi është në gjendje të kontribuojë në një debat me interes të përgjithshëm dhe jo nëse ata do t'ia dalin ta arrijnë plotësisht atë objektiv. Në rastin Erla Hlynsdottir k. Islandës (Nr. 2), një gazetar raportoi se drejtori i një qendroje rehabilitimi të krishterë dhe gruaja e tij ishin përfshirë në lojëra seksuale me pacientët e qendrës. Edhe pse gruaja nuk ishte dënuar përfundimisht, raportimi për pretendimet, të cilat përfshinin aktivitete seksuale private, kontribuoi për interesin publik.

Interesi publik vlen, ndër të tjera, për çështje që janë në gjendje të shkaktojnë polemika të konsiderueshme ose të përfshijnë një problem për të cilin publiku do të kishte interes të informohej, por nuk mund të zvogëlohet në etjen e publikut për informacione mbi jetën private të të tjerëve, dëshirën e lexuesit për sensacion ose madje edhe të vojerizmit (voyeurism), siç ishte rasti i publikimit të detajeve të aktiviteteve seksuale të Max Mosley-t në rastin e lartpërmendur të Gjykatës. Nëse qëllimi i vetëm i një artikulli është të kënaqë kureshtjen e lexuesve në lidhje me detajet e jetës private të një personi, nuk mund të konsiderohet se kontribuon në ndonjë debat me interes të përgjithshëm për shoqërinë.

### **3.3.1. Figurat publike**

Figurat publike janë persona që kryejnë detyra publike dhe/ose shfrytëzojnë burime publike. Më gjerësisht, figurat publike përfshijnë këdo që ka rol në jetën publike, pavarësisht nëse fushat ku veprojnë janë politika, ekonomia, artet, sferat sociale, sporti ose të tjera.

Jetët private të njerëzve janë bërë një mall shumë fitimprurës për disa media. Objektivat janë kryesisht figurat publike, pasi detajet e jetës së tyre private shërbejnë si një shtysë për shitje. Megjithatë, figurat publike duhet të dinë që pozita që ata kanë në shoqëri - në shumë raste sipas dëshirës - automatikisht sjell presion të shtuar mbi privatësinë e tyre.

Kur përcaktojnë nëse një person është figurë publike, ka pak rëndësi për gazetarët nëse ai person është i njohur në të vërtetë për publikun. Gazetarët nuk mund të kufizohen nga pretendimet e personave në fjalë se ata nuk janë të njohur në të vërtetë për publikun. Ajo që ka rëndësi është nëse personi ka hyrë në arenën publike duke qenë aktiv në një fushë që shqetëson publikun ose ka marrë pjesë në debat publik.

Figurat publike në mënyrë të pashmangshme dhe të vetëdijshme e bëjnë veten të hapur ndaj analizimit nga afër të çdo fjaleje të tyre nga gazetarët dhe publiku në përgjithësi. Prandaj, e drejta e tyre për ta mbrojtur jetën private nga sytë e publikut është më e kufizuar.

Liria e shprehjes në sferën politike do të merrte një goditje fatale nëse figurat publike mund të censuronin shtypin dhe debatin publik në emër të të drejtave të personalitetit.

Gjatë raportimit të çështjeve që përfshijnë aspektet e jetës private, gazetarët duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë rolit ose funksionit të personit në fjalë dhe natyrës së aktiviteteve që janë subjekt i lajmit. Varësisht nëse ai/ajo është i/e ngarkuar me funksione zyrtare, një individ do të gëzojë një të drejtë pak a shumë të kufizuar të privatësisë e tij/saj. Për shembull, princesha Caroline von Hannover konsiderohet të jetë një figurë publike, por nuk ushtron asnjë funksion zyrtar, gjë që i lejon asaj të drejtën të gëzojë një shkallë më të lartë të privatësisë, sesa ajo që gëzon një person që mban një detyrë publike.

Figurat publike me pritshmërinë më të ulët të privatësisë janë politikanët. Ushtrimi i një funksioni publik ose aspirata për zyra politike, detyrimisht ekspozon një individ (edhe pas vdekjes) ndaj vëmendjes së publikut, duke përfshirë shumë fusha që hyjnë brenda jetës private të një personi. Në rastin Editions Plon k. Francës, një gazetar dhe ish-mjeku privat i ish-presidentit francez Mitterrand shkroi një libër ku përshkroi gjendjen shëndetësore të zyrtarit të lartë francez gjatë mandatit të tij. Trashëgimtarët e ish-presidentit e paditën me sukses për të ndaluar shpërndarjen e mëtejshme të librit, duke pretenduar se ai shkeli privatësinë e ish-presidentit dhe ndërhyri në jetën personale dhe ndjenjat e gruas së tij të ve dhe fëmijëve të tij. Sidoqoftë, Gjykata vendosi në favor të gazetarit dhe mjekut, duke konstatuar se ishte në interes të publikut për të diskutuar historinë e presidentit i cili shërbeu dy mandate.

Disa veprime private të figurave publike nuk mund të konsiderohen si private për shkak të ndikimit të tyre të mundshëm, duke parë nga këndvështrimi i rolit të luajtur nga ato figura në sferat politike ose shoqërore dhe të publikut që rezultojnë interesuar për t'u informuar për to. Për shembull, arrestimi i një aktori të njohur televiziv (i cili mund të konsiderohet si njeri model për të rinjtë) për posedim dhe përdorim të drogave të paligjshme ka të ngjarë të konsiderohet çështje me interes publik që ia vlen të raportohet. Gazetarët duhet të respektojnë pritjet legjitime të figurave publike rreth privatësisë kur përfshihen në aktivitete të pastra private, siç janë: pjesëmarrja në sport, shëtitja, largimi nga një restorant, kur janë me pushime ose në marrëdhënie intime (problemet martesore, marrëdhëniet jashtëmartesore), nëse raportimi nuk kontribuon në një çështje me interes publik.

### **3.3.2. Individët privatë**

Individët privatë të cilët nuk kanë hyrë në domenin publik, në parim gëzojnë mbrojtje më të madhe të së drejtës së tyre për privatësi. Sidoqoftë, veprimet e tyre mund t'i fusin ata në sferën publike, gjë që është arsyeja se pse gazetarët nuk kanë një ndalim absolut për të raportuar për ta, edhe pa pëlqimin e tyre.

Në raste të caktuara, gazetarët mund të raportojnë dhe madje të përmendin emra individësh privatë. Në rastin Standard Verlags GmbH k. Austrisë (Nr. 3), një gazetë raportoi për humbjet e spekuara të shkaktuara nga një bankë dhe hetimin penal pasues. Në raportimin e saj, gazeta e përmendi emrin e bankierit nën hetim. Gjykata konstatoi se bankieri nuk mund të konsiderohej figurë publike si punonjës i lartë i bankës dhe bir i një politikani, por gazetari u arsyetua për publikimin e emrit të bankierit duke përmendur faktin se punonjësi i bankës kishte drejtuar thesarin e bankës në kohën kur humbjet ishin shkaktuar.

Individët privatë të përfshirë vullnetarisht në ndërmarrjet kontraverse nuk mund të presin privatësi absolute. Për shembull, gazetarët do të lejohen të përmendin emra të personave që bëjnë biznes me prostituta (ka diskutime të vazhdueshme në shumë vende nëse klubet e striptizit duhet të kenë rregulla më të rrepta ose të ndalohen krejt). Në këtë drejtim, duke zgjedhur të angazhohen në një biznes mjaft kontravers, këta persona privatë kanë hyrë në domenin publik dhe kështu janë hapur ndaj analizimit nga gazetarët.

Gazetarët duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë implikimeve më të gjera që mund të sjellë publikimi i informacioneve private të personave tjerë, siç është përjashtimi i mundshëm nga komuniteti lokal i atyre personave. Në rastin Armonienë k. Lituanië (të shtjelluar tutje më poshtë) Gjykata adresoi çështjen e një vuajtjeje të një familje të tërë nga një traumë e rëndë morale dhe psikologjike që i shtyu ata të zhvendoseshin nga fshati i tyre, pasi një gazetar zbuloi se një anëtar i asaj familjeje ishte infektuar me HIV.

### **3.4. Korniza për balancimin e të drejtave për privatësi dhe liri të shprehjes**

#### **3.4.1. Kontributi në debat për interesin e përgjithshëm**

Aspekti kryesor që një gazetar duhet të marrë parasysh kur përcaktohet nëse do të zbulojë informacione rreth jetës private të një personi është nëse lajmi mund të kontribuojë në një debat me interes të përgjithshëm. Ky koncept nuk është i dallueshëm në mënyrë domethënëse nga koncepti i interesit publik; kështu, kontributi në një debat për interesin e përgjithshëm e përkufizon objektivin e "interesit publik".

Disa shembuj nga praktika gjyqësore e Gjykatës:

- ▶ Në rastin Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës, një revistë franceze raportoi për atësinë e një fëmije jashtëmartesor nga princi Albert II I Monakos. Publikimi i këtyre informacioneve i shërbeu interesit publik për t'u informuar në lidhje me rregullat e trashëgimisë, të cilat mund t'ua ndalojnë fëmijëve jashtëmartesorë ta trashëgojnë fronin. Për më tepër, anëtarët e familjes mbretërore janë gjithashtu pjesë e historisë bashkëkohore, prandaj ekziston interesi publik në jetën e tyre.
- ▶ Në rastin White k. Suedisë, dy gazeta publikuan një seri artikujsh në të cilët vepra të ndryshme penale i atribuoheshin Anthony White nga një numër burimesh, përfshirë vrasjen e ish-kryeministrit suedez Olof Palme në vitin 1986. Gjykata konsideroi se vrasja e pazgjidhur e Olof Palme dhe pista e hetimit ishin çështje me interes dhe shqetësim serioz publik.
- ▶ Në rastin Selistö k. Finlandës, një gazetar u dënua dhe u gjykoj për shpifjen ndaj një kirurgu pasi shkroi dy artikuj që pretendonin se një pacient kishte vdekur si rezultat i konsumimit të alkoolit të kirurgut gjatë natës para operacionit. Gjykata konstatoi se rrëfimi i përvojave personale të njeriut të ve mbijetues, si dhe çështjet e sigurisë së pacientëve, kishin të bënin me një aspekt të rëndësishëm të kujdesit shëndetësor dhe si të tilla ngrenë çështje serioze duke prekur interesin publik.

- ▶ Në rastin Guseva k. Bullgarisë, një kryetar komuneje mori tre urdhra gjyqësor të formës së prerë që i kërkonin t'i jepte një përfaqësueseje të një shoqateje që punonte për mbrojtjen e të drejtave të kafshëve informacione në lidhje me trajtimin e kafshëve endacake të gjetura në rrugët e qytetit, mbi të cilin ai zyrtarizohej. Trajtimi i kafshëve konsiderohej të ishte me interes të përgjithshëm dhe të kontribuonte në debat publik.
- ▶ Në rastin Schweizerische Radio- und Fernsehgesellschaft SRG k. Zvicrës, zyrtarët e burgut refuzuan gazetarët e një stacioni televiziv kur kërkuan të kryenin një intervistë televizive me një të burgosur që vuante dënimin për vrasje. Mediat kishin synuar ta transmetonin intervistën në një prej programeve më të gjata në televizionin zviceran. Gjykata deklaroi se nuk ka dyshim se një raport për një vrasje të dënuar e cila gjithnjë kishte protestuar kundër dënimit të saj, tërhoqi interes publik dhe kontribuoi në diskutimin për funksionimin e duhur të sistemit të drejtësisë.
- ▶ Sidoqoftë, fotografitë dhe informacionet me një natyrë të pastër personale nuk konsiderohen se kontribuojnë në një debat me interes të përgjithshëm. Në rastin Von Hannover k. Gjermanisë, publikimi i fotografive të princeshës Von Hannover gjatë aktiviteteve sportive pa pëlqimin e saj rezultoi me një shkelje të së drejtës së saj për privatësi.

### 3.4.2. Roli i personit të prekur që është subjekt i raportimit

Siç u tha tashmë, një individ privat i panjohur për publikun mund të kërkojë mbrojtje të veçantë të së drejtës së tij ose të saj për jetën private, megjithëse e njëjta gjë nuk vlen për figurat publike, veçanërisht kur bëhet fjalë për politikanët.

Në rastin Renaud k. Francës, aplikanti u dënua me procedurat penale për shpifje dhe fyerje publike të një qytetari që ushtronte një mandat publik, për shkak të vërejtjeve të publikuara në uebfaqen e një shoqateje në të cilën ai ishte kryetar dhe mirëmbajtës i uebfaqes. Gjykata konstatoi se kur një debat lidhet me një temë emocionale, siç është jeta e përditshme e banorëve lokalë dhe ambientet e tyre të banimit, politikanët duhet të tregojnë një tolerancë të veçantë ndaj kritikës.

Në rastin Feldek k. Sllovakisë, një punëtor hulmues në fushën e letërsisë publikoi një autobiografi, ku ai përshkroi, ndër të tjera, dënimin e tij nga një gjykatë ushtarake sovjetike me arsyetimin se ishte urdhëruar të spiunonte ushtrinë sovjetike. Ai më vonë u bë Ministër për Kulturë dhe Arsim të Republikës së Sllovakisë dhe shtypi mbuloi pjesë nga libri. Gjykata konsideroi se ai në mënyrë të pashmangshme dhe të vetëdijshme e bëri veten të hapur ndaj analizimit nga afër të çdo fjaleje dhe vepreje të tij nga gazetarët dhe publiku në përgjithësi dhe për rrjedhojë ai duhet të tregojë një shkallë më të madhe të tolerancës.

E njëjta gjë nuk vlen për shërbyesit civilë, sepse ata me vetëdije nuk e bëjnë veten të hapur ndaj analizimit nga afër të çdo fjaleje dhe vepreje të tyre në masën në të cilën e bëjnë politikanët. Prandaj, mediat dhe gazetarët nuk duhet t'i trajtojnë ata në mënyrë të barabartë ashtu siç i trajtojnë politikanët, kur bëhet fjalë për kritikën ndaj veprimeve të tyre.

Gjithashtu, gazetarët duhet të kenë kujdes të veçantë kur raportojnë për grupe të cënueshme ose grupe që kanë nevoja specifike. Për shembull, fëmijët dhe të rinjtë duhet të mbrohen për shkak të cënueshmërisë së qenësishme që nënkupton mosha e tyre, e cila vlen edhe në kontekstin e mbulimit nga mediat.



Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet pjekurisë së një fëmijeje kur citohen komentet e tij/saj. Fëmija mund të mos jetë i vetëdijshëm sa duhet për ndikimin e fjalëve të tij/saj dhe media ka një përgjegjësi etike të mos i shkaktojë dëme një fëmijeje.

Për më tepër, në rastet kur prindërit ose përfaqësuesit ligjorë japin komente negative, të ndjeshme ose të tjera të papërshtatshme për fëmijët nën kujdesin e tyre, gazetarët duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë interesit më të mirë të fëmijës. Ata duhet të publikojnë një informacion të tillë vetëm kur ekziston një interes mbizotërues i publikut, por të shmangin përmendjen e emrit të fëmijës, përveç nëse është e nevojshme, në mënyrë që të shmanget një asociim i përrjetshëm me komente negative ose të turpshme.

Në raste të tilla, kur emri i fëmijës nuk përmendet dhe atij nuk i tregohet fytyra, gazetarët gjithashtu duhet të shmangin publikimin në mënyrë indirekte të informacionit për identifikimin e fëmijës (siç janë fotografitë e prindërve ose vendndodhja e saktë e familjes, etj.).

Kur kryhen hulumtime në mesin e njerëzve që kërkojnë mbrojtje, kërkohet kufizim, veçanërisht në lidhje me personat që nuk zotërojnë plotësisht aftësitë e tyre mendore ose fizike ose që i janë ekspozuar një situatë jashtëzakonisht emocionale. Gazetarët duhet të shmangin shfrytëzimin e cenueshmërisë së këtyre personave për të marrë informacion.

### **3.4.3. Sjellja e mëparshme e personit në fjalë**

Nëse keni dhënë intervista për gazetarët në të kaluarën, nëse jeni prezent në media në një formë tjetër, madje edhe nëse keni bashkëpunuar me shtypin në raste të mëparshme, kjo nuk mund të shërbejë si një argument për privimin tuaj nga e drejta për privatësi.

Zbulimi vullnetar i informacionit për një figurë publike mund ta dobësojë shkallën e mbrojtjes për të cilën ai person ka të drejtë. Në rastin Hachette Filipacchi Associés ("Ici Paris") k. Francës, një gazetar shkroi një artikull për një këngëtar të famshëm (të shoqëruar me fotografi) që u referohej vështirësive ekstravagante financiare të këngëtarit dhe shijeve të tepruara. Këngëtari pretendoi shkeljen e privatësisë, por pa sukses, pasi që ai tashmë kishte zbuluar informacione në autobiografinë e tij në lidhje me mënyrën se si menaxhoi dhe i shpenzoi paratë e tij. Gazetari informacionet i kishte marrë nga autobiografia e këngëtarit.

Në rastin e modeles dhe personazhit të njohur ndërkombëtarisht Naomi Campbell, (të shtjelluar më poshtë), duke pasur parasysh mohimet e saj të mëparshme publike për përdorim të drogës, faktet thelbësore të varësisë së saj nga droga dhe faktit që ajo ishte në trajtim, këto çështje ishin në mënyrë të ligjshme me interes publik dhe të mundshme për publikim.

Në një rast tjetër që përfshin publikimin e fotove të dasmave, të shtjelluar përsëri më poshtë, Gjykata mori parasysh faktin se njëri nga aplikantët, i cili ishte vetë gazetar dhe prezantues televiziv, kishte zbuluar tashmë aspekte të jetës së vet para publikut në një shkallë të caktuar. Për këtë dhe arsye të tjera, publikimi i fotove ishte i justifikuar, megjithëse ai i kërkoi shtypit paraprakisht të mos raportonte për dasmën dhe ndërmori masa paraprake për të parandaluar mbulimin nga shtypi.

### **3.4.4. Metoda e marrjes së informacionit dhe vërtetësia e tij**

Gazetarët janë të obliguar të veprojnë me mirëbesim dhe përgjegjësitë e tyre përfshijnë ofrimin e fakteve të sakta dhe informacionit të besueshëm dhe të saktë në përputhje me etikën e gazetarisë. Për shembull, në rastet e vdekjeve traumatike, pikëllimi i ndjerë nga familja e viktimës duhet t'i shtyjë gazetarët të tregojnë maturi dhe kujdes.

Gazetarët duhet të përdorin mjete të lejuara për të marrë informacion dhe të tregojnë respekt për personin e përfshirë. Në rastin Von Hannover k. Gjermanisë, përdorimi i kamerave me lente të gjata për ta fotografuar fshehtas princeshën, përderisa ajo ishte me pushime, nuk u konsiderua "mënyrë e drejtë" për marrje të informacionit. Sidoqoftë, publikimi i fotografive të një këngëtarit të nxjerrë nga materiali reklamues në rastin Hachette Filipacchi Associés ("Ici Paris") k. Francës u konstatua të ishte pranueshëm.

Gazetarët duhet të kenë kujdes që një artikull i shkruar dhe i cunguar për ta çorientuar lexuesin ka më pak të ngjarë të kontribuojë në një debat me interes publik. Saktësia e informacionit të shpërndarë është një parim themelor për mbrojtjen e së drejtës për privatësi.

### **3.4.5. Përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimeve**

Është e rëndësishme që gazetarët të marrin në konsideratë mediumin e publikimit dhe mënyrën se si personi në fjalë përfaqësohet në të. Për shembull, shprehja artistike në një poezi ka një ndikim shumë më të kufizuar sesa media masive.

Sa i përket përmbajtjes, kujdes i veçantë duhet të bëhet kur figurat publike paraqiten në mënyrë negative, pasi që ka më shumë të ngjarë të rezultojë në shkelje të privatësisë. Sidoqoftë, nocioni i lirisë së shprehjes mbron jo vetëm përmbajtjen, por edhe formën dhe stilin e të shprehurit. Për shembull, përshkrimet satirike, të cilat kanë në vetvete një shkallë ekzagjerimi dhe shtrembërimi të realitetit, vlerësohen ndryshe nga deklaratimet e faktuara.

Po kështu, mënyra se si shpërndahet publikimi - në median kombëtare ose lokale me qarkullim të madh ose të kufizuar - është gjithashtu një faktor i rëndësishëm. Për shembull, media audiovizuale dhe ato në internet shpesh kanë një efekt shumë më të menjëhershëm dhe më të fuqishëm sesa media e shtypur.

Gjatë publikimit të informacionit për çështje private, gazetarët duhet t'i kushtojnë vëmendje ndikimit të mundshëm të informacionit në jetën e njerëzve para shpërndarjes. Ndikimi mund të jetë aq negativ sa të detyrojë një familje të tërë të zhvendoset nga fshati i tyre, siç u përmend në rastin HIV më lart, ose të çojë në një revokim të birësimi (rasti i Ageyev k. Rusisë). Duhet të merret parasysh që në disa vende kundërshtimi ndaj qeverisë mund të nënkuptojë rrezik për jetën ose forma të tjera të kërcënimeve, gjë që kërkon një shqyrtim të kujdesshëm nëse duhet të zbulohet ndonjë informacion personal i individëve që përballen me ndjekje penale si rezultat i publikimit.

## 4. Çështjet specifike të jetës private

---

### 4.1. Familja, shtëpia, prona

Familjarët, të afërmit dhe miqtë e figurave publike, duke mos qenë vetë figura publike, gëzojnë një shkallë më të lartë të privatësisë, megjithëse ka raste në të cilat gazetarëve u lejohet të raportojnë për ta. Në rastin Flinkkilä dhe të tjerët k. Finlandës, publikimi i emrit, moshës, fotografisë, vendit të punës dhe detajeve të marrëdhënies familjare të partnerit të një figureje publike nuk u konsiderua se ishte shkelje e privatësisë, sepse ajo ishte e përfshirë në një incident në familje, i cili kishte rezultuar me akuzën për prishje të rendit publik (duke u akuzuar penalisht, gjobitur dhe dënuar).

Artikujt për fëmijët e figurave publike shfaqen rregullisht në gazeta. Nëse publikime të tilla bëhen vetëm për të shkaktuar thashetheme, gazetarët nuk gëzojnë mbrojtje të fortë të së drejtës së tyre për lirinë e shprehjes. Në rastin Zvagulis k. Lituanisë, një gazetë që raportonte se një yll i shquar popi kishte një fëmijë jashtëmartesor, shkeli të drejtën e tij për privatësi, pasi që gazeta nuk ishte në gjendje ta lidhë këtë informacion me veprimtarinë profesionale të yllit të muzikës pop. Gjykata konsideroi se ekzistenca e fëmijës nuk shkoi përtej sferës private dhe se publikimi ishte stresues për figurën publike dhe i dëmshëm për integritetin psikologjik të fëmijës.

E drejta për privatësi përfshin jo vetëm të drejtën për një hapësirë fizike aktuale, por edhe gëzimin e qetë të asaj hapësireje. Adresa e shtëpisë së një personi përmban të dhëna personale; prandaj është e mbrojtur dhe në parim nuk duhet të vihet në dispozicion të publikut nga gazetarët. Në rastin Alkaya k. Turqisë, një gazetare që raportonte për vjedhjen e shtëpisë së një aktoreje të famshme, shkeli të drejtën e saj për privatësi duke zbuluar adresën e shtëpisë së saj. Gjykata konstatoi se edhe kur kishte supozuar interesin publik për të raportuar se ajo ishte vjedhur, nuk kishte asnjë interes të tillë për t'i publikuar detajet e sakta të adresës së shtëpisë së saj. Lokacioni i vendeve të tjera që lidhen me sferat e jetës private mund të jetë problematik, siç është rasti i qendrës së trajtimit të frekuentuar nga N. Campbell.

## 4.2. Integriteti fizik dhe moral

### Informacioni Mjekësor

Gazetarët duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë informacionit mjekësor, sepse është me rëndësi thelbësore për një person që t'i gëzojë të drejtat e tij/saj për respektim të privatësisë. Është thelbësore që jo vetëm të respektohet ndjenja e privatësisë së një pacienti, por edhe të ruhet besimi i tij ose saj në profesionin mjekësor dhe shërbimet shëndetësore në përgjithësi. Përndryshe, ndikimi mund të jetë aq negativ saqë ata që kanë nevojë për ndihmë mjekësore mund të hezitojnë të zbulojnë informacion të tillë për të marrë trajtimin e duhur.

Në rastin Fürst-Pfeifer k. Austrisë, një artikull në lidhje me një ekspert psikologjik të regjistruar për procedurat gjyqësore, u publikua në dhjetor 2008 në një uebsajt të lajmeve rajonale. Artikulli thoshte në mënyrë të veçantë që eksperti psikologjik vuante nga probleme psikologjike, siç janë: luhajtje disponimi dhe sulme paniku, por punonte si ekspert i caktuar gjykateje për shumë vite. Sipas Gjykatës, një debat serioz për gjendjen e shëndetit mendor të një eksperti psikologjik, i nxitur ngadyshimet e arsyetuara, duhej të shihej si debat me interes të përgjithshëm, pasi një ekspert në procedurat gjyqësore i kërkohet t'i plotësojë standardet e aftësive fizike dhe psikologjike.

Në rastin Armonienė k. Lituanisë, gazeta e përditshme më e madhe kombëtare publikoi detaje në lidhje me gjendjen mjekësore të një personi privat që vuante nga HIV-i. Pasi që personi në fjalë vdiq, gruaja e tij i vazhdoi procedurat ligjore. Gjykata konstatoi se zbulimi publik i gjendjes së shëndetit të burrit dhe paraqitja e emrit, mbiemrit dhe vendbanimit nuk ishte në interes të publikut. Përmes konfirmimit të informacionit për sëmundjen e burrit, punonjësit e qendrës së AIDS-it mund të kishin ndikuar negativisht në gatishmërinë e të tjerëve për t'u ekzaminuar vullnetarisht për HIV.

Në rastin Mitkus k. Letonisë, gazeta shkeli privatësinë e një të burgosuri kur raportoi se ai ishte i infektuar me HIV. Artikulli përmbante një fotografi, megjithëse autoritetet gjyqësore kombëtare e kishin ndaluar publikimin e tij. Gjykata konstatoi se meqenëse tiparet e të burgosurit ishin qartë të dukshme (u përmendën emri i tij dhe shkronja e parë e mbiemrit të tij, detajet e regjistrimit të tij penal dhe vendi i burgimit), ishte krejtësisht e mundur që shokët e tij të burgosur dhe persona të tjerë mund ta identifikonin atë dhe të sillleshin ndryshe me të, duke u bazuar në këtë gjendje shëndetësore.

### Integriteti Moral

Në parim, do të jetë e vështirë për një gazetar të justifikojë raportimin në lidhje me marrëdhëniet private, veçanërisht ato intime të figurave publike, nëse ato nuk kontribuojnë në një debat me interes të përgjithshëm. Në rastin Standard Verlags GmbH k. Austrisë (Nr.2), një gazetë shkeli privatësinë e personave në fjalë kur publikoi një artikull ku komentoheshin thashethemet se gruaja e presidentit të atëhershëm austriak kërkoi të divorcohej prej tij dhe po mbante kontakte të ngushta me një politikan tjetër. Sipas Gjykatës, gazetarët mund të raportojnë informacione në lidhje me gjendjen shëndetësore të politikanëve, të cilat mund t'i pengojnë ata në kryerjen e detyrave të tyre, por e njëjta liri nuk vlen për thashethemet e kota për martesat e tyre.

### 4.3. E drejta ndaj imazhit të tjetrit

Imazhi i një personi përbën një nga atributet kryesore të personalitetit të tij ose të saj, pasi që zbulon karakteristikat unike të personit dhe e dallon atë nga të tjerët. Është një komponent thelbësor i zhvillimit personal dhe të gjithë kanë të drejtë të kontrollojnë përdorimin e imazheve të tyre. Në këtë drejtim, publikimi i një fotografie në përgjithësi përbën një ndërhyrje më thelbësore në të drejtën e privatësisë, sesa komunikimi i thjeshtë i emrit të një personi.

Individët kanë të drejtë ta refuzojnë publikimin e imazheve të tyre dhe të kundërshtojnë incizimin, konservimin dhe riprodhimin e imazhit nga një person tjetër.

Gazetarët duhet, në parim, të sigurojnë pëlqimin e personit në fjalë në kohën kur bëhet fotografia dhe jo thjesht nëse dhe kur publikohet. Përndryshe, një atribut thelbësor i personalitetit (imazhi) do të varej nga palët e treta dhe personi në fjalë nuk do të kishte kontroll mbi të.

Siç është përmendur tashmë në pjesët e mësipërme, imazhet e marra pa pëlqimin e personave në fjalë ose fshehurazi pa dijeninë e tyre, do të rezultojnë me shkelje të së drejtës për privatësi, përveç nëse konsiderohet se kontribuojnë në një debat me interes publik.

Në rastin Mgn Limited k. Mbretërisë së Bashkuar, një gazetë publikoi një artikull në lidhje me supermodelen Naomi Campbell. Titulli në faqen e saj të parë ishte: "Naomi: Unë jam narkomane" dhe një artikull më i gjatë brenda gazetës shtjelloi trajtimin e varësisë së Campbell. Artikujt shoqëroheshin me foto të bëra fshehurazi pranë qendrës anonime kundër narkotikëve ku ajo po shkonte për trajtim në atë kohë. Gjykatat kombëtare arritën në përfundimin se publikimi i informacionit ishte justifikuar si çështje me interes publik, duke pasur parasysh që Campbell më parë kishte mohuar publikisht përdorimin e drogës dhe artikujt që zbuluan se ajo po trajtohej për varësi nga droga. Sidoqoftë, ndonëse publikimi i këtij informacioni ishte justifikuar, Gjykata konstatoi se publikimi i fotografive shtesë ishte fyes dhe shqetësues për të dhe shkelte të drejtën e saj për ta respektuar jetën private.

Në rastin Müller k. Gjermanisë, aplikantët u informuan së pari në lidhje me vetëvrasjen e supozuar të djalit të tyre (dhe më vonë u konfirmua) nga një artikull i gazetës që paraqiste fotografinë e djalit të tyre. Ndërsa publikimi i fotografisë pa pëlqimin e tyre konsiderohej shkelje e privatësisë së aplikantëve, artikulli shoqëruar ishte i saktë dhe në asnjë mënyrë shpifës dhe vetë fotografia nuk mbartte ndonjë veçori. Për më tepër, aplikantët kanë mundur të kërkonin urdhër gjyqateje për të parandaluar publikimin e mëtejshëm të informacioneve të pakonfirmuara. Efekti i kombinuar i këtyre faktorëve uli peshën e cenimit të privatësisë, kështu që aplikantëve nuk iu dha dëmshpërblim.

#### 4.3.1. Raste specifike të fotografimit dhe filmimit

##### Imazhet e ngjarjeve të dhunshme ose traumatike

Si pjesë të përgjegjësisë të tyre, gazetarët duhet të jenë të ndjeshëm gjatë publikimit të informacioneve në lidhje me njerëzit që preken nga tragjedia e pikëllimit, pasi publikimi i një informacioni të tillë mund të rezultojë me shkelje të së drejtës së privatësisë së të prekurve. Në rastin Hachette Filipacchi Associates k. Francës, një revistë e përjavshme publikoi një

artikull të ilustruar me një fotografi të trupit të një zyrtari të lartë, të vrarë, të shtrirë në rrugë, ku shihej edhe fytyra e tij. Familjarët e paditën me sukses revistën për shkelje të privatësisë.

## CCTV

Gazetarët duhet të përmbahen nga publikimi i pamjeve të marra nga videosur vejimi (CCTV) i personave privatë pa i maskuar fotografitë, përveç nëse ato informacione kontribuojnë në një debat me interes të përgjithshëm. Në rastin Peck k. Mbretërisë së Bashkuar, një individ privat (i cili vuante nga depresioni, por nuk ishte akuzuar për ndonjë vepër penale) u incizua ndërsa po shëtiste në rrugë me një thikë kuzhine në dorë dhe më pas u përpoq të çajë kyçet e dorës. Publikimi i këtyre pamjeve nga këshilli lokal dhe media u konsiderua se ishte në kundërshtim me të drejtën e tij për privatësi.

## Kamerat e fshehura

Gazetarët hulumtues lejohen të përdorin kamera të fshehura për të incizuar intervista me figura jopublike vetëm në kushte të caktuara. Përdorimi i kamerave të fshehura lejohet kur: a) çështja kontribuon në debatin publik; b) raportimi nuk përqendrohet personalisht në person, por në njërin nga aspektet e tij/saj profesionale; c) fytyra dhe zëri i personit maskohet dhe d) intervista nuk kryhet në ambiente të zakonshme pune.

Në rastin Haldimann dhe të tjerët k. Zvicrës, katër gazetarë u përfshinë në incizimin dhe transmetimin e një dokumentari mbi shitjen e produkteve të sigurimeve të jetës, përkundër një historiku të pakënaqësisë publike me praktikën e përdorura nga brokerët e sigurimeve. Dokumentari përmbante sekuencat e një intervisteje të incizuar nga kamera e fshehur për të nxjerrë në pah praktikën e këqija të një brokeri sigurimesh. Gjykata vendosi që ndërhyrja në jetën private të brokerit, i cili kishte vendosur të mos shprehte mendimin në intervistë, nuk kishte qenë aq serioze sa ta tejkalonte interesin publik për të marrë informacione mbi praktikën e keqe të pretenduar në fushën e shitblerjes së sigurimeve.

Sidoqoftë, funksionet e një individi ose kremtimet e tij, nuk mundin në asnjë rrethanë të justifikojnë përndjekjen nga media ose publikimin e fotografive [ose informacionit] të siguruar përmes operacioneve mashtruese ose klandestine ose zbulimeve që portretizojnë detaje të jetës private të një individi dhe përbëjnë një ndërhyrje në intimitetin e tyre.

## Bërja e fotografive në dasmat e figurave të njohura

Raportimi për dasma të figurave të njohura dhe publikimi i fotografive të ceremonive, lejohen në parim, sepse ato kanë një anë publike, në kushte të caktuara, edhe pa pëlqim.

Në rastin Sihler-Jauch dhe Jauch k. Gjermanisë, një revistë e përjavshme publikoi një artikull të ilustruar me disa fotografi në lidhje me dasmën e një prezantuesi të njohur televiziv. U vendos që gazetari të mos shkelte të drejtën për privatësi të çiftit, sepse prezantuesi ishte i njohur dhe kishte një ndikim të madh në formimin e opinionit publik. Për më tepër, lista e të ftuarve kishte emra të spikatur, ku përfshihej edhe kryebashkiaku i Berlinit dhe çifti nuk u portretizua në një dritë negative.

Po kështu, në rastin Lillo-Stenberg dhe Saether k. Norvegjisë, një muzikant dhe aktor i njohur dhe partnerja e tij u ankuan se shtypi ua shkeli privatësinë gjatë dasmës së tyre. Një revistë publikoi një artikull me dy faqe në lidhje me dasmën, të shoqëruar nga gjashtë fotografi, pa pëlqimin e çiftit. Gjykata vlerësoi se privatësia e tyre nuk ishte shkelur, sepse ngjarja u zhvillua në një vend të hapur dhe të qasshëm, ata nuk u portretizuan në një dritë negative dhe dasma e tyre ishte një çështje më pak private sesa do të ishte një ceremoni martesore.

## Fëmijët

Gazetarët duhet të shmangin publikimin e fotografive të fëmijëve të figurave publike nëse një informacion i tillë nuk kontribuon në një debat me interes publik. Në rastin Kahn kundër Gjermanisë, fotografitë e dy fëmijëve dhe gruas së Oliver Kahn, një ish-portieri të ekipit kombëtar gjerman të futbollit, u paraqitën në një revistë. Gazetarët u gjobitën sepse kishin shkelur të drejtën e familjes për privatësi. Të gjitha fotot treguan fëmijët në shoqërinë e prindërve të tyre ose me pushime, megjithëse objekt i raporteve nuk kishin qenë vetë fëmijët, por përkundrazi marrëdhënia e prindërve të tyre dhe karriera e Oliver Kahn.

Në rastin Reklós dhe Davourlis kundër Greqisë, marrja e fotografive të një fëmijeje të sapolindur pa pëlqimin e prindërve të tij (në njësinë intensive në të cilën vetëm personeli i spitalit duhet të kishte qasje) konsiderohej se ishte një shkelje e së drejtës për privatësi, ndonëse fotot nuk u publikuan.

## 4.4. Korrespondenca

Në rastin Leempoel & S.A. ED. Ciné Revue k. Belgjikës, një gjykatëse po dëshmonte në një hetim parlamentar për trajtimin e një lëndeje të caktuar. Asaj iu kërkua ta dorëzonte dosjen që kishte sjellë me vete gjatë përgatitjes. Dosja përfshinte shënime personale në lidhje me mbrojtjen e saj dhe rekomandimet e avokatit të saj për mënyrën e komunikimit dhe sjelljes së saj përpara komisionit. Një revistë publikoi një artikull që përmbante ekstrakte të gjata nga dosja përgatitore. Gjykata konsideroi se privatësia e saj ishte shkelur, sepse artikulli përmbante kritika ndaj karakterit të gjykatëses dhe përfshinte një kopje të korrespondencës që ishte private, në kuptimin më strikt dhe që nuk mund të vlerësohej se kontribuonte në asnjë mënyrë në ndonjë debat me interes të përgjithshëm për shoqërinë.

## 5. Raportimi i krimeve

**G**jatë raportimit për krime, gazetarët duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë faktit nëse personi në fjalë është i njohur për publikun. Fakti i vetëm që një person i nënshtrohet hetimit penal, madje edhe për një vepër shumë të rëndë, nuk justifikon trajtimin e tij/saj në të njëjtën mënyrë si një figurë publike që është më i ekspozuar ndaj publikut.

### 5.1. Parimet e përgjithshme

Publiku ka interes legjitim për t'u informuar në lidhje me krimet, procedurat hetimore dhe gjykimet. Ndërsa qëllimi i raportimit të krimit është të informojë publikun, gazetari sidoqoftë duhet të raportojë në mirëbesim duke u përmbajtur nga publikimi i akuzave të pabazuara dhe të paverifikuara.

Në veçanti, gazetarët nuk duhet ta paraqesin një person si fajtor, derisa dënimi të mos jetë shqiptuar nga një gjykatë. Duhet bërë një dallim i qartë midis dyshimit dhe dënimit. Si praktikë e mirë, media mund të specifikojë nëse një person ka pranuar fajësinë apo jo, duke marrë parasysh që një pranim i fajësisë nuk duhet të paraqitet si një faj i dëshmuar.

### 5.2. Të drejtat e viktimave (të mitur) për mbrojtje të identitetit të tyre

Në rastin Krone Verlag GmbH & Co KG dhe Krone Multimedia GmbH & Co KG k. Austrisë, një gazetë zbuloi identitetin e një viktimeje të mitur të abuzimit seksual duke publikuar fotografinë e saj në uebsajtin e saj. Megjithatë çështja kishte të bënte me një shqetësim publik, duke pasur parasysh se as autorët e krimit, e as viktima nuk ishin figura publike ose nuk kishin hyrë më parë në sferën publike, zbulimi i identitetit të tyre nuk ishte i nevojshëm për t'i kuptuar hollësitë e çështjes. Fëmija nuk ishte figurë publike dhe nuk u konsiderua nga Gjykata që ajo kishte hyrë në skenën publike duke u bërë viktimë e një veprje penale, e cila tërhoqi vëmendje të konsiderueshme të publikut.

### 5.3. E drejta për privatësi të një pedofili të prezumuar

Në rastin Y k. Zvicrës, një gazetar u konstatua se shkeli të drejtën e privatësisë së një personi të ndjekur penalisht për pedofili, i cili përfundimisht u la i lirë. Artikulli përmbante një sasi të konsiderueshme informacionesh të hollësishme dhe ekstrakte nga deklaratimet e ankuesit në polici, i cili u vlerësua se ishte në kundërshtim me të drejtën e tij për privatësi dhe nuk kontribuoi në një debat publik.



## 5.4. Zbulimi i identitetit të zyrtarit policor të hetuar

Në rastin Wirtschafts-Trend Zeitschriften-Verlagsgesellschaft k. Austrisë, një revistë lajmesh publikoi një artikull me fragmente të procesverbalit të hetimeve preliminare në procedurat penale kundër tre zyrtarëve të huaj policorë që ishin në një fluturim deportimi. Të deportuarit që po shoqëroheshin, kishin vdekur në rrethana të paqarta. Gjykata vendosi që zbulimi i identitetit të një zyrtari nga revista e lajmeve kishte ndikuar negativisht në jetën e tij private dhe sociale dhe duhej bërë kujdes i veçantë për ta mbrojtur atë ndaj dëmit nga media.

## 5.5. Personat e dyshuar

Gazetarëve u lejohet në parim të publikojnë fotografi të figurave publike nën hetim, p.sh. nën dyshimin e evazionit fiskal në shkallë të gjerë. Në rastin Verlagsgruppe News GmbH k. Austrisë (Nr.2), gazeta publikoi një artikull në lidhje me hetimet e pezulluara mbi dyshimin për evazion fiskal në shkallë të gjerë kundër drejtorit menaxhues të një prodhuesi të njohur të pistoletave. Një raportim i tillë nuk u konsiderua se cenonte të drejtën për privatësi të drejtorit menaxhues.

Gazetari duhet të jetë shumë më i kujdesshëm kur bëhet fjalë për persona më pak të njohur. Në rastin Khuzhin dhe të tjerët k. Ruisë, publikimi (gjatë një "talk show") i fotografive të pasaportave të personave të akuzuar për rrëmbim dhe torturim ndodhi disa ditë para se gjykimi i tyre të rezultonte me një shkelje të së drejtës së tyre për privatësi.

## 5.6. Publikimi i aspekteve banale të personave të akuzuar

Në rastin Bedat k. Zvicrës, një gazetar u konsiderua se kishte shkelur të drejtën për privatësi të një personi privat të akuzuar për tri vdekje në lidhje me një aksident me makinë. Gjykata vlerësoi se publikimi i shënimeve të intervistave, deklarimeve të bëra nga gruaja dhe doktori i të akuzuarit dhe letrat e dërguara nga i akuzuari te gjykatësi hetues lidhur me aspektet banale të jetës së tij të përditshme në paraburgim, nuk kontribuuan në një debat publik. Për më tepër, Gjykata deklaroi se gazetari kishte paraqitur një pamje mjaft negative të personit të akuzuar, duke përshtatur një ton kuazi-tallës, me fotografi të mëdha në afërsi të të akuzuarit, bashkë me tekstin si dëshmi se gazetari kërkonte të krijonte një artikull sensacional.

## 5.7. Personat nën përkujdesje

Në rastin Toma k. Rumanisë, pasi policia kishte marrë një person në paraburgim për posedim droge, disa zyrtarë policorë kontaktuan gazetarët dhe i ftuan t'i incizojnë fotografitë e personit në fjalë në selinë e policisë. Gjykata konstatoi se e drejta e këtij personi për privatësi ishte shkelur.

Në një rast tjetër, Khmel k. Ruisë, policia kishte ftuar gazetarët në stacionin policor për të filmuar një anëtar të legjislaturës rajonale, i cili u arrestua nën dyshimin për vozitje në gjendje të dehur dhe sjellje jo të rregullt. Disa nga pamjet u publikuan në televizion dhe u konsiderua se ky publikim ishte në kundërshtim me të drejtën e tij për privatësi.

## **5.8. Personat e dënuar në situata emocionale**

Në rastin Egeland dhe Hanseid k. Norvegjisë, dy gazeta kishin publikuar, megjithëse pa pëlqim, fotografi të një gruaje që do të merrej për të vuajtur dënimin me burg për kohë të gjatë, për të cilin ajo sapo ishte dënuar. Megjithëse fotografitë kishin të bënin me një ngjarje publike dhe ishin marrë në një vend publik, në një kohë kur identiteti i saj ishte tashmë i njohur për publikun, Gjykata konstatoi se portretizimi i gazetave për të kishte qenë veçanërisht ndërhyrës, pasi ishte me lot në sy dhe në ankth të madh. Ajo sapo ishte arrestuar brenda një gjykatoreje, pasi ishte njoftuar për një aktgjykim që e dënonte atë për një vrasje të trefishtë që përfshinte dënimin më të rëndë.

## **5.9. Personat e dënuar të liruar më kusht**

Shpesh ndodh që autoritetet publike, veçanërisht organet e zbatimit të ligjit, të lëshojnë fotografi të personave të kërkuar, arrestuar ose liruar me kusht. Në parim, gazetarëve u lejohet të ripublikojnë fotografi të tilla. Në rastin Österreichischer Rundfunk k. Austrisë, ishte e pranueshme të transmetohej fotografia e kryetarit të një organizateje neo-naziste, i cili ishte liruar me kusht. Sipas Gjykatës, interesi i tij për të mos e zbuluar pamjen e tij fizike nuk ishte më i rëndësishëm, sesa fakti që ai ishte një person famëkeq që kishte kryer krime të një natyreje politike.

## 6. Kodet e sjelljes dhe mjetet vetërregulluese

---

**K**odet e sjelljes dhe organet vetërregulluese ose mekanizmat që përfshijnë publikuesit, gazetarët, shoqatat e përdoruesve të mediave, ekspertët e botës akademike dhe gjyqtarët, janë elementë thelbësorë që kontribuojnë në një praktikë të ekuilibruar dhe etike të gazetarisë.

Në përgjithësi, gazetarët inkurajohen t'i respektojnë këto mjete vetërregulluese.

Një përmbledhje e zgjeruar e kodeve të sjelljes mund të gjendet në faqen e Gazetarisë së Përgjegjshme, një projekti bashkëpunues që ofron një gamë të gjerë burimesh për gazetarë dhe këshillash për raportim etik, duke shpjeguar etikën globale të shtypit dhe sistemet e rregullimit (<https://accountablejournalism.org/ethics-codes/international>).

# 7. Parimet për mbrojtjen e të dhënave

## 7.1. Të drejtat e individëve

Mediat duhet t'i zbatojnë detyrimet e tyre, sipas Kushtetutës dhe sipas Konventës, për ta siguruar privatësinë e individëve.

Për më tepër, sipas nenit 9 të Konventës 108, shmangiet nga parimet themelore të mbrojtjes së të dhënave mund të lejohen, për shembull që të sigurojnë lirinë e shprehjes, vetëm kur këto shmangie parashikohen nga Ligji i Palëve në Konventë dhe përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të mbrojtjes së subjektit të të dhënave ose të të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Gazetarët më pas duhet të vlerësojnë, sipas rastit, nëse lejohen të shmangen nga parimet themelore të mbrojtjes së të dhënave në rrethana specifike.

Si rezultat, parimet kryesore për mbrojtjen e të dhënave mund të zbatohen deri diku edhe për përpunimin e të dhënave personale të mediave për veprimtaritë e tyre gazetare.

Sa u përket të drejtave të individit, sipas nenit 8 të Konventës 108, individët kanë të drejtë (kur nuk aplikohen shmangie sipas nenit 9) të:

- ▶ krijojnë një dosje automatike të të dhënave personale, qëllimet e tyre kryesore, si dhe identitetin dhe vendbanimin e zakonshëm ose vendin kryesor të biznesit të kontrolluesit të dosjes;
- ▶ marrin në interval të arsyeshëm dhe pa vonesë të tepërt ose konfirmim të shpenzimeve, nëse të dhënat personale që lidhen me të janë të ruajtura në dosjen automatike të të dhënave, si dhe komunikimin me atë të këtyre të dhënave në një formë të kuptueshme;
- ▶ bëjnë, sipas rastit, korrigjim ose fshirje të të dhënave të tilla, nëse këto janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e ligjit vendor që u japin fuqi ligjore parimeve themelore të mbrojtjes së të dhënave;
- ▶ kenë mjet juridik nëse nuk përmbushet një kërkesë për konfirmim ose, sipas rastit, komunikim, korrigjim ose fshirje.

Sipas kornizës së re legjislativë të Bashkimit Evropian, me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave, të drejtat e individëve madje do të forcohen dhe individët do të marrin informacion më të gjerë në kohën e mbledhjes dhe do të kenë, për shembull, të drejtën për ta fshirë informacionin ("e drejta për t'u harruar"), të drejtën për bartjen e të dhënave të tyre personale, etj.

Shmangiet nga këto të drejta lejohen vetëm nëse ato parashikohen me Ligjin e palëve dhe përbëjnë një masë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të mbrojtjes së subjektit të të dhënave ose të të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

b. Në përgjithësi dhe varësisht nga kërkesat e ligjit kombëtar, individët kanë të drejtë të marrin informacion në lidhje me të dhënat e ruajtura nga media e përgjegjshme.

Një kërkesë e tillë mund të refuzohet nëse zbulimi i informacionit do të dëmtojë veprimtaritë gazetare (zbulimi i burimeve, i një hetimi që po zhvillohet, etj.), do të shkelte të drejtat e palëve të treta ose do ta afektonte në një mënyrë disproporcionale lirinë e shprehjes.

Procedurat për ta trajtuar kërkesën për qasje duhet të miratohen nga mediat. Në rast të refuzimit për ta përmbushur një kërkesë, media duhet t'i regjistrojë arsyet e këtij vendimi dhe t'ia komunikojë ato personit në fjalë.

c. Lajmet ose pohimet e publikuara, të cilat më pas rezultojnë të pasakta, duhet të korrigojnë menjëherë në një mënyrë të përshtatshme nga redaktori.

Korrigjimi me të cilin publikohen faktet e vërteta duhet t'i referohet artikullit të pasaktë. Faktet e vërteta duhet të publikohen edhe nëse gabimi është pranuar në një formë tjetër. Në rastin e publikimit në internet, korrigjimi duhet të lidhet me përmbajtjen fillestare. Nëse publikimi bëhet brenda vetë publikimit fillestar, ai duhet të shënohet si l tillë.

Korrigjimi, tërheqja ose përgënjeshtrimi duhet të ruhen së bashku me publikimin fillestar dhe për të njëjtën periudhë kohore.

Media duhet të ketë procedura për të siguruar ushtrimin e së drejtës së përgjigjes dhe të drejtën për të marrë korrigjimin e informacionit të rremë pas publikimit, të cilat janë edhe më thelbësore në rastet kur të drejtat për qasje dhe korrigjim kanë qenë të kufizuara para publikimit (Shih Nenin 29 Grupi Punues, Rekomandimi 1/97, "Ligji për mbrojtjen e të dhënave dhe mediat", 25 shkurt 1997).

d. Të dhënat personale të mbledhura në kundërshtim me të drejtat e personave në fjalë duhet të bllokohen në mundësinë e parë dhe të fshihen përfundimisht nga redaktori.

e. Çdo person duhet të ketë të drejtë të parashtrojë një ankesë dhe të ketë një mjet efektiv juridik në rast të shkeljes së të drejtës së tij për mbrojtjen e të dhënave, duke qenë i informuar për të drejtat e tij në mënyrë që mjetet juridike të jenë efektive në praktikë dhe të mos mbeten thjesht teorike.

Personat në fjalë duhet të jenë në gjendje t'i adresojnë ankesat e tyre drejtpërdrejt në median raportuese, në një organ vetërregullues dhe përfundimisht në autoritetin për mbrojtjen e të dhënave ose në gjykata.

Ata gjithashtu duhet të gëzojnë kompensim të duhur në përpjesëtim me shkëlqen dhe pasojat e saj.

Në rastin Avram dhe të tjerët k. Moldavisë, aplikantët, pesë gra, u ankuan për transmetimin në televizionin kombëtar më 10 maj 2003 të pamjeve nga një video e tyre intime në një saunë me pesë burra, katër prej të cilëve ishin zyrtarë policorë. Pamjet u përdorën në një program gazetar kundër korrupsionit dhe veçanërisht në gazetën "Accentë". Gjykata vuri në dukje se ndërhyrja në të drejtën për privatësi të aplikantëve nuk ishte në kundërshtim. Është pranuar nga gjykatat kombëtare dhe aplikantët për dhënie kompensimi.

Në aktvendimin e saj, Gjykata konsideroi se shumata e dhëna në nivelin kombëtar kishin qenë shumë të ulëta për të qenë në përpjesëtim me një ndërhyrje kaq serioze në të drejtën e aplikantëve për të respektuar jetën e tyre private, siç ishte transmetimi i pamjeve nga videoja e tyre intime në televizionin kombëtar.

Gjykata mori parasysh efektin dramatik në jetën private, familjare dhe shoqërore të aplikantëve dhe dha një kompensim shtesë.

## **7.2. Masat e sigurisë**

Masat e duhura të sigurisë ndërmerren për mbrojtjen e të dhënave personale të ruajtura në dosjet automatike të të dhënave, kundër shkatërrimit aksidental ose të paautorizuar ose humbjes aksidentale, si dhe kundër qasjes, ndryshimit ose shpërndarjes së paautorizuar.

Mediat duhet të ndërmarrin hapa të duhur dhe të arsyeshëm për t'i ruajtur të dhënat personale në mënyrë të sigurt dhe për të parandaluar vjedhjen, humbjen ose keqpërdorimin e qëllimshëm ose nga neglizhenca. Ato duhet të mbrojnë pajisjet teknike (politikë për fjalëkalim të fortë, kontrolle për kyçje, enkriptim, kopje rezervë të përshtatshme, antivirus dhe firewall, etj.) që përdoren brenda dhe jashtë organizatës (USB, telefona të mençur, laptopë, etj.).

Media duhet të miratojë në të njëjtën kohë masa dhe politika të sigurisë fizike (brava, alarme, qasje të kufizuar në objekte, etj.). Masat e menaxhimit dhe organizimit duhet të miratohen, për shembull, për të rregulluar marrëdhëniet me përpunuesit dhe nënkontraktorët, për të përcaktuar një numër të kufizuar të personave që do të kenë mundësi të qasën në të dhëna personale ose të organizojnë një ndarje të rreptë të aktiviteteve gazetare dhe joeditoriale.

## **7.3. Përpunimi i përmbajtjes joeditoriale**

a. Fushëveprimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave është jashtëzakonisht i gjerë dhe media duhet të ketë parasysh se parimet e mbrojtjes së të dhënave janë plotësisht të zbatueshme në lidhje me përmbajtjen joeditoriale.

“Përrjashtimi medial” është i nevojshëm, por kufizohet rreptësisht në përmbajtjen editoriale dhe gazetare. Ky përjashtim nuk vlen për aktivitetet e tjera të mediave, për shembull kur ato përpunojnë të dhëna personale për qëllime komerciale ose administrative.

Në rastin e dytë, mediat duhet të konsiderohen si kontrollues “tradicionale” të të dhënave dhe t'i respektojnë plotësisht kërkesat për mbrojtje të të dhënave.

Për shembull, media duhet të zbatojë plotësisht parimet e mbrojtjes së të dhënave gjatë përpunimit të të dhënave personale në lidhje me abonuesit e tyre (për shembull për qëllime reklamimi) ose me punonjësit e tyre.

Gjatë përpunimit të të dhënave personale, shtypi në këtë mënyrë duhet të bëjë një dallim të qartë midis qëllimeve editoriale dhe tregtare ose administrative.

b. Të dhënat personale të mbledhura për qëllime joeditoriale do të përpunohen vetëm nëse ekziston një bazë ligjore për përpunimin. Parimet e mbrojtjes së të dhënave do të respektohen në çdo kohë.

Ekzistenca e bazës ligjore për përpunimin e të dhënave është parakusht për legjitimitetin e vetë përpunimit.

Së bashku me ekzistencën e bazës ligjore për përpunimin e të dhënave, mediat duhet të marrin parasysh parimet e mëposhtme të përpunimit të të dhënave:

- ▶ të dhënat duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, pa cenuar dinjitetin e një subjekti të të dhënave;
- ▶ të dhënat mund të përpunohen vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë dhe legjitime. Përpunimi i mëtejshëm i të dhënave për qëllime që nuk janë në përputhje me qëllimin fillestar, do të jetë i papranueshëm;
- ▶ të dhënat mund të përpunohen vetëm në masën e nevojshme për ta arritur qëllimin legjitim përkatës. Të dhënat duhet të jenë adekuate dhe proporcionale me qëllimin për të cilin përpunohen;
- ▶ të dhënat duhet të jenë të vlefshme, të sakta dhe të azhurnuara, nëse është e nevojshme. Të dhënat e mbledhura pa bazë ligjore dhe të parëndësishme për qëllimin e përpunimit, duhet të bllokohen, fshihen ose shkatërrohen;
- ▶ të dhënat mund të mbahen vetëm për periudhën e nevojshme për ta arritur qëllimin e përpunimit të të dhënave.  
Pas arritjes së qëllimit, ato duhet të bllokohen, fshihen ose shkatërrohen, ose ruhen në një formë që përjashton identifikimin e një personi, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.

Të gjitha parimet e mbrojtjes së të dhënave merren parasysh njëkohësisht.

## 7.4. Praktikrat më të mira për të siguruar dhe demonstruar pajtueshmëri

Si çështje të praktikës së mirë, mediat duhet t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat për mbrojtje të të dhënave dhe ta demonstrojnë këtë pajtueshmëri.

Mund të përmendet për shembull dobia e mjeteve të mëposhtme të "llogaridhënies":

- ▶ emërimi i një zyrtari për mbrojtjen e të dhënave;
- ▶ krijimi i një regjistri të aktiviteteve të përpunimit të mbrojtjes së të dhënave;
- ▶ përpunimi i një politikeje të privatësisë;
- ▶ procedurat e brendshme për t'i marrë parasysh implikimet e mbrojtjes së të dhënave në faza kryesore të një aktiviteti gazetar dhe të miratojë vendime të shpejta në rastet e vështirësive etike;
- ▶ procedurat e brendshme për të hartuar njoftime informuese, për të trajtuar ankesat e individëve, për të paralajmëruar menaxhimin e organizatës, për të kontaktuar autoritetin për mbrojtjen e të dhënave, për t'u marrë me rastet e shkeljeve të sigurisë, etj.;
- ▶ elaborimi i një vlerësimi të ndikimit në privatësi në rast rreziqesh për individët;
- ▶ auditime të rregullta për ta verifikuar dhe siguruar pajtueshmërinë;
- ▶ shqyrtimi i kontratave dhe marrëdhënive me përpunuesit dhe nënkontraktorët;
- ▶ trajnimi themelor për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë për gazetarët dhe stafin;
- ▶ aktivitetet e ndërgjegjësimit (informacioni i qartë për individët, faqja e dedikuar për mbrojtjen e të dhënave dhe të privatësisë në uebfaqe ose intranet; etj.).

"Mjetet për llogaridhënie" përkatëse mund të përshtaten me madhësinë dhe burimet e mediave.

## 8. Referencat

---

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe e Lirive Themelore

### **Neni 8 – E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare**

1. Gjithkush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, shtëpisë së tij dhe korrespondencës së tij.

2. Nuk do të ketë asnjë ndërhyrje nga autoriteti publik në ushtrimin e kësaj të drejteje, përveçse atyre në përputhje me ligjin dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, parandalimit të trazirave apo krimit, mbrojtjes së shëndetit ose të moralit, ose mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve.

### **Neni 10 - Liria e shprehjes**

1. Gjithkush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audiovizual, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, mbrojtjes së rendit dhe parandalimit të krimit, mbrojtjes së shëndetit ose të moralit, mbrojtjes së dinjitetit ose të të drejtave të tjerëve, ndalimit të përhapjes së të dhënave konfidenciale ose garantimit të autoritetit dhe paanshmërisë së sistemit gjyqësor.

### **Dokumente të Këshillit të Evropës**

Konventa për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale

Rekomandimi CM/Rec(2018)1 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për pluralizëm medial dhe transparencë të pronësisë së mediave.

Rekomandimi CM/Rec(2016)4 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve dhe të aktorëve të tjerë të mediave. Rekomandimi CM/Rec(2011)7 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi një nocion të ri të medias

Deklarata nga Komiteti i Ministrave mbi mbrojtjen dhe promovimin e gazetarisë hulumtuese (26 shtator 2007)



Rezoluta 2066 (2015), Përgjegjësia dhe etika e mediave në një mjedis ndryshues të mediave, Asambleja Parlamentare

Rezoluta 1843 (2011), Mbrojtja e privatësisë dhe e të dhënave personale në internet dhe media online, Asambleja Parlamentare

Rezoluta 1165 (1998), E drejta për privatësi, Asambleja Parlamentare

Rezoluta 1003 (1993), Etika e gazetarisë, Asambleja Parlamentare

## **Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut**

A. A k. Norvegjisë, Nr. 28070/06, 9 prill 2009

Ageyev k. Ruisë, Nr. 7075/10, 18 prill 2013

Alkaya k. Turqisë, Nr. 42811/06, 9 tetor 2012

Armonienė k. Lituanisë, Nr. 36919/02, 25 nëntor 2008

Axel Springer Ag k. Gjermanisë [GC], Nr. 39954/08, 7 shkurt 2012

Bédat k. Zvicrës [GC], Nr. 56925/08, 29 mars 2016

Biriuk k. Lituanisë, Nr. 23373/03, 25 nëntor 2008

Björk Eiðsdóttir k. Islandës, Nr. 46443/09, 10 korrik 2012

Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë Nr. 21980/93, 20 maj 1999

Bodrožić k. Serbisë, Nr. 32550/05, 23 qershor 2009.

Bohlen k. Gjermanisë Nr. 53495/09 dhe Ernst August von Hannover k. Gjermanisë Nr. 53649/09, 19 shkurt 2015

Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës [GC], Nr. 40454/07, 10 nëntor 2015

Dorothea Sihler-Jauch k. Gjermanisë dhe Günther Jauch k. Gjermanisë, Nr. 68273/10 dhe 34194/11, 24 maj 2016 (vendim)

Egeland dhe Hanseid k. Norvegjisë, Nr. 34438/04, 15 prill 2009

Erla Hlynsdóttir (Nr.2), Nr. 54125/10, 21 tetor 2014

Feldek k. Sllovakisë, Nr. 29032/95, 12 korrik 2001

Flinkkilä dhe të tjerët k. Finlandës, Nr. 25576/04, 6 prill 2010

Fürst-Pfeifer k. Austrisë, Nr. 33677/10 dhe 52340/10, 17 maj 2016

Guseva k. Bullgarisë, Nr. 6987/07, 17 shkurt 2015

Hachette Filipacchi Associés k. Francës, Nr. 71111/01, 14 qershor 2007

Hachette Filipacchi Associés k. Francës [GC], Nr. 40454/07, 10 nëntor 2015

Hachette Filipacchi Associés (&quot;Ici Paris&quot;) k. Francës, Nr. 12268/03, 23 korrik 2009

Haldimann dhe të tjerët k. Zvicrës, Nr. 21830/09, 24 shkurt 2015

Janowski k. Polonisë, Nr 25716/94, 21 janar 1999

A. A k. Norvegjisë, Nr. 28070/06, 9 prill 2009  
Ageyev k. Ruisë, Nr. 7075/10, 18 prill 2013  
Alkaya k. Turqisë, Nr. 42811/06, 9 tetor 2012  
Armonienë k. Lituanië, Nr. 36919/02, 25 nëntor 2008  
Axel Springer Ag k. Gjermanisë [GC], Nr. 39954/08, 7 shkurt 2012  
Bédat k. Zvicrës [GC], Nr. 56925/08, 29 mars 2016  
Biriuk k. Lituanië, Nr. 23373/03, 25 nëntor 2008  
Björk Elösdóttir k. Islandës, Nr. 46443/09, 10 korrik 2012  
Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë Nr. 21980/93, 20 maj 1999  
Bodrožić k. Serbisë, Nr. 32550/05, 23 qershor 2009.  
Bohlen k. Gjermanisë Nr. 53495/09 dhe Ernst August von Hannover k. Gjermanisë  
Nr. 53649/09, 19 shkurt 2015  
Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés k. Francës [GC], Nr. 40454/07, 10 nëntor 2015  
Dorothea Sihler-Jauch k. Gjermanisë dhe Günther Jauch k. Gjermanisë, Nr. 68273/10  
dhe 34194/11, 24 maj 2016 (vendim)  
Egeland dhe Hanseid k. Norvegjisë, Nr. 34438/04, 15 prill 2009  
Erla Hlynsdóttir (Nr.2), Nr. 54125/10, 21 tetor 2014  
Feldek k. Sllovakisë, Nr. 29032/95, 12 korrik 2001  
Flinkkilä dhe të tjerët k. Finlandës, Nr. 25576/04, 6 prill 2010  
Fürst-Pfeifer k. Austrisë, Nr. 33677/10 dhe 52340/10, 17 maj 2016  
Guseva k. Bullgarisë, Nr. 6987/07, 17 shkurt 2015  
Hachette Filipacchi Associés k. Francës, Nr. 71111/01, 14 qershor 2007  
Hachette Filipacchi Associés k. Francës [GC], Nr. 40454/07, 10 nëntor 2015  
Hachette Filipacchi Associés (&quot;lci Paris&quot;) k. Francës, Nr. 12268/03, 23 korrik  
2009  
Haldimann dhe të tjerët k. Zvicrës, Nr. 21830/09, 24 shkurt 2015  
Janowski k. Polonisë, Nr 25716/94, 21 janar 1999



Këto udhëzime përmbajnë një grumbull të standardeve të Këshillit të Evropës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me mbrojtjen e privatësisë së figurave publike dhe individëve privat në media. Përveç kësaj, në të përfshihen edhe parimet e mbrojtjes së të dhënave bazuar në instrumente të ndryshme rregullative dhe praktikak më të mira.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

SQI